

VENDIM
Nr.524, datë 30.7.2004

PËR MASËN DHE MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË BANESËS DHE TË USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Oficeri aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që për shkak të detyrës emërohet larg vendbanimit të tij dhe kur nuk trajtohet nga Ministria e Mbrojtjes me banesë ose kredi në vendemërimin e ri, përfiton kompensim për qira banese deri në tre vjet, në masën dhe kriteret e përcaktuara si më poshtë vijon:

a) 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut për qira banese të tipit garsonier, kur nuk ka persona të tjerë në ngarkim;

b) 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut për qira banese të tipit 1+1, kur ka në ngarkim deri në dy persona;

c) 80 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut për qira banese të tipit 2+1, kur ka në ngarkim më shumë se dy persona.

Çmimi mesatar i qirasë së banesës përcaktohet, çdo vit, nga Ministria e Financave dhe Ministria e Mbrojtjes, duke u bazuar në të dhënat e Institutit të Statistikës (INSTAT).

2. Oficerët, që përfitojnë kompensim për qira banese, duhet të paraqesin pranë strukturës ushtarake përkatëse këto dokumente:

a) Kërkesën për kompensimin e qirasë së banesës;

b) Certifikatën personale;

c) Certifikatën familjare;

ç) Urdhrin e Ministrisë të Mbrojtjes për emërimin në detyrë jashtë vendbanimit;

d) Kontratën e qirasë së banesës, të noterizuar.

3. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura (oficer, nënoficer dhe ushtar profesionist), i emëruar jashtë vendbanimit, i cili nuk e ka ndryshuar vendbanimin familjar, pasi nuk ka pasur mundësi strehimi, dhe nuk përfiton kompensim për qira banese, gëzon të drejtën e kompensimit në vlerë për ushqim, për tre vakte, sipas normës nr.4, të përcaktuar në vendimin nr.160, datë 9.7.1995 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të trajtimit me ushqim të efektivave, për ditët efektive të punës.

4. Ushtarakët e tjerë të shërbimit aktiv gëzojnë të drejtën e kompensimit në vlerë për ushqim vetëm për vaktin e drekës, sipas normës nr.4, të përcaktuar në vendimin nr.160, datë 9.7.1995 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të trajtimit me ushqim të efektivave, për ditët efektive të punës.

5. Masa e vlerës për kompensimin e ushqimit përcaktohet, çdo vit, nga Ministri i Mbrojtjes, në bazë të çmimeve mesatare vjetore, sipas buletinit të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Kur ushtaraku thirret në repart për nevoja shërbimi (gatishmëri, stërvitje, fushime) trajtohet me ushqim të gatuar sipas normës së repartit dhe nuk përfiton kompensim në vlerë.

7. Vendimi nr.505, datë 24.10.1994 i Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me ushqim të kuadrove ushtarakë aktivë, që shërbejnë në strukturat e ushtrisë", i ndryshuar, nuk zbatohet për ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

9. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano